

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVU E OBRAZOVANJA NAUKË I TEHNOLOGJIE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org Org.Jednica Org Unit	018
Nr. Prot.	1774
Eroj Prot.	
Prot.No.	
Data:	
Datum:	28, 05, 20 15
Date:	
Nr. I faqeve Br.stranica No. pages	2
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku
i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology**

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Prishtinë, 28 maj 2015

Ref. 204/01B

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të neneve 92 dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenet 4, 21, 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2010), nenin 8 (1.4) dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (Gazeta Zyrtare, Nr. 1, 18 prill 2011), nxjerr:

V E N D I M

1. Me datat 6 qershor 2015 (e shtunë) dhe 20 qershor 2015 (e shtunë) pezullohen të gjitha aktivitetet në institucionet arsimore me qëllim të organizimit dhe mbarëvajtjes së Provimit Shtetëror të Maturës.
2. Obligohen të gjitha Drejtoritë Komunale për Arsim, institucionet arsimore dhe Fakulteti i Edukimit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" që të pezullojnë në këto data të gjitha aktivitetet që përfshijnë angazhimin e mësimit në punë apo aktivitete tjera, si dhe qendrat ku mësimit janë të përfshirë në programin e AKM-së, përveç aktiviteteve që ndërlidhen me organizimin dhe mbarëvajtjen e Provimit Shtetëror të Maturës.
3. Obligohen të gjitha Drejtoritë Komunale për Arsim, që të pezullojnë në këto data të gjitha aktivitetet e OJQ-ve apo të ngjashme që përfshijnë angazhimin e mësimit në trajnime apo aktiviteteve tjera, përveç aktiviteteve që ndërlidhen me organizimin, monitorimin dhe mbarëvajtjen e Provimit Shtetëror të Maturës.
4. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Duke u bazuar në dispozitat e lartcekura si dhe duke pasur parasysh faktin se një pjesë e mësimdhënësve të të gjitha niveleve të arsimit të Republikës së Kosovës do të jenë të angazhuar në administrimin e Provimit Shtetëror të Maturës, me qëllim të organizimit dhe mbarëvajtjes sa më të mirë të Provimit Shtetëror të Maturës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Arsim BAJRAMI

Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Vendimi ju dërgohet:

1. Komisionit Qendror Shtetëror të Maturës
2. Rektorit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina";
3. Fakultetit të Edukimit (Qendrat në Prishtinë, Prizren, Gjakovë dhe Gjilan);
4. Drejtorive Komunale për Arsim;
5. Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT;
6. Arkivit.